



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

www.qpz.gov.al

Nr.177

2 dhjetor

2008

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr.10 017 datë 13.11.2008	Për përcaktimin e poligoneve për asgjësimin e municioneve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë 8769
Vendim i KM nr.1472, datë 12.11.2008	Për shtyrjen e afatit të përfundimit të procedurave të prokurimit për Ministrinë e Drejtësisë dhe institucionet, në varësi të saj, si autoritete kontraktore 8781
Vendim i KM nr.1473, datë 12.11.2008	Për shtyrjen e afatit të botimit të njoftimit të fituesit dhe të njoftimit të kontratës së lidhur, për procedurat e prokurimit, të kryera nga Shërbimi Informativ i Shtetit, si autoritet kontraktor..... 8782
Vendim i KM nr.1474, datë 12.11.2008	Për lejimin e kalimit tranzit të dy automjeteve dhe të disa trupave ushtarake italiane, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë 8782
Vendim i KM nr.1476, datë 12.11.2008	Për disa ndryshime në vendimin nr.781, datë 14.11.2007 të Këshillit të Ministrave “Për karakteristikat teknike e funksionale të pajisjeve fiskale, sistemit të integruar të kompjuterizuar për transferimet periodike, automatike, të deklarimeve financiare, sistemit të komunikimit, për procedurën e dokumentacionit për miratimin e tyre, dhe për kriteret për pajisjen, me autorizim, të shoqërive, të autorizuar për ofrimin e pajisjeve fiskale” ... 8783

Vendim i KM nr.1477, datë 12.11.2008	Për disa shtesa në vendimin nr.1114, datë 30.7.2008 të Këshillit të Ministrave “Për disa çështje në zbatim të ligjeve nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve, shoqërore dhe shëndetësore, në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar	8784
Vendim i KM nr.1478, datë 12.11.2008	Për një shtesë në vendimin nr.1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave për prokurimin publik”, të ndryshuar	8786
Vendim i KM nr.1479, datë 12.11.2008	Për shtyrjen e afatit të kryerjes së procedurave të prokurimit për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, si autoritet kontraktor ...	8786
Vendim i KM nr.1480, datë 12.11.2008	Për miratimin e shtesës nr.2 të kontratës së miratuar me vendimin nr.665, datë 18.12.2002 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e projektkontratës, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe “Lockheed Martin Global, Inc”, për modernizimin e shërbimit të trafikut ajror shqiptar”, të ndryshuar	8788
Vendim i KM nr.1482, datë 12.11.2008	Për hapjen e programeve të studimit, të ciklit të dytë, pranë Universitetit Politeknik të Tiranës, në vitin akademik 2008-2009	8797
Vendim i KM nr.1483, datë 12.11.2008	Për një shtesë në vendimin nr.547, datë 9.8.2006 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore”	8798
Vendim i KM nr.1484, datë 12.11.2008	Për një shtesë në vendimin nr.23, datë 9.1.2008 të Këshillit të Ministrave “Për tarifat e përdorimit të ujit”	8798
Vendim i KM nr.1485, datë 12.11.2008	Për disa ndryshime në vendimin nr.160, datë 13.2.2008 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e numrit të punonjësve, për vitin 2008, në ministritë dhe institucionet qendrore”, të ndryshuar	8799
Vendim i KM nr.1486, datë 12.11.2008	Për lejimin e kalimit tranzit të dy autokolonave ushtarake italiane, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë	8800
Vendim i KM nr.1518, datë 12.11.2008	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i pikës së kalimit kufitar Qafë Botë/Konispol	8801
Udhëzim i MF nr.37, datë 20.11.2008	Për përdorimin e të ardhurave nga procesi i legalizimit	8804
Udhëzim i MASH nr.39, datë 11.11.2008	Për ngritjen e komisionit të verifikimit dhe të marrjes në dorëzim të pajisjeve të mobilierisë për arsimin bazë dhe të mesëm, në institucionet e varësisë së MASH	8805
Vendim i ERE nr.127, datë 14.11.2008	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Enpower Albania” sh.p.k. për kryerjen e aktivitetit të tregtimit të energjisë elektrike	8806

Vendim i ERE nr.128, datë 14.11.2008	Për autorizimin e shoqërisë “E-Vento s.r.l. Albania”, për ndryshimin e aksionarit që kontrollon interesat (zotëron paketën kontrolluese).....	8807
Vendim i KKRT nr.739, datë 7.11.2008	Për zgjerimin e zonës së licencimit të subjektit radiofonik privat vendor “Radio Logos”.....	8807
Vendim i KKRT nr.740, datë 7.11.2008	Për zgjerimin e zonës së licencimit të subjektit televiziv privat vendor “TV Ora”	8808
Vendim i KKRT nr.741, datë 7.11.2008	Për dhënie licence për televizionin vendor privat “TV D1”	8808
Vendim i KKRT nr.742, datë 7.11.2008	Për dhënie licence për radion vendore private “Radio City”..	8809
Vendim i KKRT nr.743, datë 7.11.2008	Për mosdhënie licence për radion private vendore “Radio Ora”.	8809
Vendim i KKRT nr.744, datë 7.11.2008	Për mosdhënie licence për radion private vendore “Radio Alfa Kabëll”	8810
Vendim i KKRT nr.745, datë 7.11.2008	Për mosdhënie licence për radion private vendore “Radio G-Kam”	8810
	Vendim (i shkurtuar) për shpalljen të vdekur të shtetasit Kristaq Zarka	8811
	Vendim (i shkurtuar) për heqjen e zotësisë për të vepruar shtetases Enerjeta Nazarko dhe caktimin e Fatmira Nazarkos si kujdestare të saj.....	8811
	Vendim (i shkurtuar) për shpalljen të vdekur të shtetasit Nesim Braho	8811
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Gjilard Gjinollari.....	8811
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetases Age Elezi.....	8811
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Sali Tabaku	8811
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Shyqyri Xhevit Matopalaj	8812
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Klement Metushi ..	8812

LIGJ
Nr.10 017, datë 13.11.2008

**PËR PËRCAKTIMIN E POLIGONEVE PËR ASGJËSIMIN E MUNICIONEVE TË FORCAVE
TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Ky ligj përcakton sipërfaqet e territorit, prona të shtetit apo në pronësi të subjekteve të tjera, të cilat mund të përdoren si poligone për asgjësimin e municioneve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, si dhe mënyrën e administrimit të tyre.

Neni 2

Në këtë ligj, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Poligon për asgjësimin e municioneve” është një sipërfaqe territori, me përmasa e kufizime të caktuara, që shërben për asgjësimin e municioneve të kalibrave të ndryshëm, në përdorim të Forcave të Armatosura.
2. “Zonë sigurie” është një sipërfaqe territori, hapësire ajrore dhe detare, që kufizon, nga të gjitha anët, rrethore, poligonin për zhvillimin normal të asgjësimit të municioneve luftarake.

KREU II
PËRCAKTIMI I POLIGONEVE

Neni 3

1. Poligonet e asgjësimit të municioneve të Forcave të Armatosura përcaktohen në këtë ligj.
2. Këto poligone mund të përdoren edhe për asgjësimin e municioneve të Policisë së Shtetit dhe të municioneve të kapura e të grumbulluara nga kjo polici. Asgjësimi i municioneve, për këtë rast, do të bëhet sipas një marrëveshjeje ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Brendshme.

Neni 4

Poligonet për asgjësimin e municioneve

1. Poligonet për asgjësimin e municioneve të Forcave të Armatosura janë:
 - a) poligoni “Livadhet e Hamzit”, Pukë;
 - b) poligoni “Shën Noi Madh”, Bizë;
 - c) poligoni “Zgarë”, Librazhd;
 - ç) poligoni i Shënmmrisë, Gramsh;
 - d) poligoni “Përroi i Bigazit”, Skrapar;
 - dh) poligoni “Fushë Roshaj”, Voskopojë;
 - e) poligoni i Trajlarit, Këlcyrë;
 - ë) poligoni “Jubë”, Sukth, Durrës.
2. Koordinatat e poligoneve të asgjësimit të municioneve të Forcave të Armatosura janë të përcaktuara në genplanet, që i bashkëlidhen këtij ligji.

KREU III
ADMINISTRIMI I POLIGONEVE

Neni 5
Administrimi i poligoneve

1. Sipërfaqja e territorit të poligoneve të asgjësimit të municioneve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, gjatë periudhës së asgjësimit të tyre, administrohet nga Ministria e Mbrojtjes.

2. Sipërfaqja e tokës së poligoneve, që nuk është pronë shtetërore, do të merret, për nevoja të asgjësimit të municioneve, në përdorim të përkohshëm, në përputhje me ligjin nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”.

Neni 6
Marrja e një sipërfaqeje toke jashtë poligonit

Ministria e Mbrojtjes, për nevoja të asgjësimit të municioneve, mund të marrë, në raste të veçanta, në përdorim të përkohshëm, një sipërfaqe jashtë territoreve të poligoneve të përcaktuara në këtë ligj, vetëm sipas ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”.

Neni 7
Funksionimi i poligoneve

Për funksionimin dhe administrimin e poligoneve, Ministri i Mbrojtjes miraton rregulloret përkatëse, të propozuara nga Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura.

Neni 8
Miratimi paraprak i kërkesës për ndërtim

Ndërtimi i objekteve të përkohshme dhe të përhershme, brenda territorit të poligoneve dhe brezit të sigurisë, bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe vetëm me miratimin paraprak të Ministrit të Mbrojtjes.

Neni 9
Rajone tokësore, hapësira detare dhe korridore ajrore të kufizuara

1. Ministria e Mbrojtjes, për nevoja të asgjësimit të municioneve, përcakton rajone tokësore, hapësira detare e korridore ajrore të kufizuara përkohësisht për qarkullim, lundrim, fluturim, gjueti e çdo veprimtari tjetër, që krijon premisa për shkaktim dëmi, duke njoftuar 30 ditë përpara, me shkrim, organet përkatëse.

2. Për përcaktimin e zonave të kufizuara dhe njoftimin e organeve përkatëse, në zbatim të këtij neni, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministria e Brendshme, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve nxjerrin një udhëzim të përbashkët.

Neni 10
Vendet e ndaluara për realizimin e asgjësimit të municioneve

Ndalohet realizimi i asgjësimit të municioneve në det, jashtë kufirit shtetëror dhe jo më afër se 4 km nga instalimet e shpimit dhe të shfrytëzimit të naftës, nga qendrat e banuara, rezervuarët, digat dhe vendet me rezerva të burimeve nënujore, monumentet e natyrës, monumentet e kulturës të kategorisë I e II, si dhe në zonat e tyre të mbrojtura, në korridoret e hyrjes e të daljes së aviacionit civil, në hapësirën ajrore të vendit.

KREU IV
KOMPENSIMI I DËMEVE DHE NJOFTIMI I POPULLSISË

Neni 11
Mënyra e kompensimit të dëmeve

1. Dëmet e shkaktuara, si rrjedhojë e asgjësimit të municioneve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, kompensohen në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe sipas marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes dhe palëve të dëmtuara.

2. Nëse konflikti nuk zgjidhet me marrëveshje, atëherë palët i drejtohen gjykatës përkatëse.

Neni 12

Dëmtimet e mjedisit

1. Dëmet që i shkaktohen mjedisit, si pasojë e asgjësimit të municioneve luftarake, rimbursohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, megjithëse forcat ushtarake, që kryejnë asgjësimin e municioneve në këto poligone, janë të detyruara të marrin masat e nevojshme, për të minimizuar në maksimum dëmet, që mund t'i shkaktohen mjedisit.

2. Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit e Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve nxjerrin udhëzimin e përbashkët për mënyrën e kthimit në gjendjen fillestare të mjedisit të dëmtuar dhe të rimbursimit të fondeve të nevojshme.

Neni 13

Bashkëpunimi me institucionet

1. Njësitë përkatëse të Forcave të Armatosura, 30 ditë përpara zhvillimit të asgjësimit të municioneve, njoftojnë organet e qeverisjes vendore, në territorin e të cilave shtrihet poligoni, apo të atyre, me të cilat kufizohet poligoni.

2. Organet e qeverisjes vendore janë të detyruara që, brenda 5 ditëve nga data e marrjes së njoftimit, të bëjnë njoftimin e popullsisë përreth. Njoftimi bëhet 5 ditë rresht në gazetën vendore, televizionet vendore, si dhe për komunat, që nuk i kanë këto mjete, me shpallje në një vend të dukshëm.

3. Ministria e Mbrojtjes bashkëpunon me Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik për kryerjen në terren tëurvejimit arkeologjik, para fillimit të operacioneve të asgjësimit të municioneve, si dhe gjatë kohës së kryerjes së tyre.

4. Ministria e Mbrojtjes bashkëpunon me Komitetin Shtetëror të Mbrojtjes së Tokës për parandalimin e dëmtimeve, që mund t'i bëhen tokës bujqësore, gjatë kryerjes së asgjësimit të municioneve në poligone.

KREU V

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 14

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministria e Brendshme, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve që, brenda gjashtë muajve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit, të nxjerrin udhëzimin e përbashkët, në zbatim të nenit 9 të këtij ligji.

2. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve që, brenda gjashtë muajve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit, të nxjerrin udhëzimin e përbashkët, në zbatim të nenit 12 të këtij ligji.


Neni 15

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekreten nr.5950, datë 24.11.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

POLIGONI I TRAJLARIT (KËLCYRË)



SHPJEGUSE

Ndodhet në komunën Dishnicë, rreth 6.7 km larg qytetit të Këlcyrës.

Largësia nga qendra e shpërthimit deri tek shtëpia e parë e fshatit është 770 m.

Sipërfaqe e poligonit të asgjësimit është 1 538 600 m², ndërsa e vatrës së asgjësimit 25447 m².

Koordinatat Gjeografike të poligonit të asgjësimit dhe të vatrës N=40°21'49.1" dhe E=20°13'25.4".



Distanca e sigurisë



Vatra e asgjësimit

PE- Pikë furnizimi materiale eksplozive

PGMA- Pikë grumbullimi municione për asgjësim




Roje

POLIGONI GRYKEDERDHA E LUMIT ERZEN JUBE-DURRES.

POLIGONI FUSHE ROSHAJ (VOSKOPOJE)

Shpjegje



1. Distanca nga qyteti me i afë Voskopoje ne vije ajrore = 4.4 km
2. Distanca nga rruga nacionale Voskopoje Gjergjevice = 1.22 km
3. Koordinatat gjeografike te vates se asgjesimit dhe poligonit

N = 40 35' 47.9"

E = 20 36' 33.7"

4. siperfaqja e vates se asgjesimit = 25446.9 m².
5. siperfaqja e poligonit te asgjesimit = 3141592. 65m²

○ Distanca e sgrunesë

⊕ Vatra e asgjesimit

■ Pika grumbullimi municionesh per asgjesim

■ Pika përmirizimi me materijale eksploziv

◇ Rrëze

SHKALLA 1 : 10 000

POLIGONI ZGARE (LIBRAZHD)



Shpjegje

1. Distanca nga qyteti me i afert Librazhd ne vije ajrore = 4.5 km.
2. Distanca nga rruga nacionale Elbasan-Librazhd = 6.07 km.
3. Koordinatat gjeografike te vates se asgjesimit dhe poligonit.

N = 41 11' 59.41"

E = 20 16' 11.56"

4. siperfaqja e vates se asgjesimit = 25446.9 m2.
5. siperfaqja e pooligonit te asgjesimit = 3141592. 65m2



Distanca e Sigurisë

Vatra e asgjesimit

PE. Pikkë furnizimi me materiale eksplozive
PGMA Pikkë grumbullimi municionesh për asgjesim

Rrëze

SHKALLA 1 : 10 000

POLIGONI SHËN NOI MADH (BIZË)

SHPJEGJESË

Distanca 49 km në VL të qytetit të Tiranës.

Fshatrat Shëngjergjit, Verria, Burimasi, Ballgjinasi, Kostenja, Ballenja, Thekna, Peshku., janë 2-7 km larg poligonit.

Sipërfaqe e poligonit të asgjësimit është 3 141 593 m², ndërsa e vatrës së asgjësimit 25 447 m².

Koordinatat Gjeografike të poligonit të asgjësimit dhe të vatrës

N=41°20'55.2" dhe
E=20°10'53.5".



Distanca e sigurisë




Vatra e asgjësimit

PE- Pikë furnizimi materiale eksplozive

PGMA- Pikë grumbullimi municione për asgjësim



Roje




POLIGONI LIVADHET E HAMZIT (PUKE)

Shpjeguese

1. Distanca nga qyteti me i af Puka ne vije ajrore = 7.8 km
2. Distanca nga rruga nacion Puke-Kukes = 12.32 km.
3. Koordinatat gjeografike te vatres se asgjesimit dhe poligonit
 $N = 41^{\circ} 58' 55.32''$
 $E = 19^{\circ} 56' 38.09''$
4. sipërfaqja e vatres se asgjesimit = 25446.9 m².
5. sipërfaqja e poligonit te asgjesimit = 3141592. 65m²

- Distanca e sigurisë
- ⊕ Vatra e asgjesimit
- PE Pikë furnizimi me materiale eksplo
- PGMA Pikë grumbullimi municionesh për as
- ◇ Roje



POLIGONI PËRROI I BIGASIT (SKRAPAR)

SHPJEGJESË

Ndodhet në largësi mbi 4.5 km nga qyteti i Çorovodës.

Largësia nga qendra e shpërthimit deri tek shtëpia e parë e fshatit Dhorës është 1.3 km, ndërsa deri tek depoja më e afërt është 300 m.

Sipërfaqe e poligonit të asgjësimit është 282 600 m², ndërsa e vatrës së asgjësimit 7850 m².

Koordinatat Gjeografike të poligonit të asgjësimit dhe të vatrës N=40°27'38.6" dhe E=20°16'53.2".



Distanca e sigurisë



Vatra e asgjësimit




PE- Pikë furnizimi materiale eksplozive



PGMA- Pikë grumbullimi municione për asgjësim



Roje



POLIGONI I SHËNMËRIZË (GRAMSH)



SHPJEGUSE

Distanca nga qyteti i Gramshit në vijë ajrore është 5.2 km, ndërsa nga rruga automobilistike Gramsh-Lozhan është 4.5 km. Sipërfaqe e poligonit të asgjësimit është 1 538 600 m², ndërsa e vatrës së asgjësimit 25 447 m².

Koordinatat Gjeografike të poligonit të asgjësimit dhe të vatrës

N=40°49'48.4"

E=20°09'11.2"



Distanca e sigurisë



Vatra e asgjësimit



PE- Pikë furnizimi materiale eksplozive




PGMA- Pikë grumbullimi municione për asgjësim



Roje

POLIGONI GRYKEDERDHA E LUMIT ERZEN JUBE-DURRES

TEMLI I KOORDINATAVE SHIFTERORE



1. Distanca nga fs

Jub ne vije ajrore

2. Distanca nga rr

Tirane-Durres =

3. Koordinatat gje

vatres se asgjesin

N = 41 26'

E = 19 27'

4. sipërfaqja e vat

asgjesimit = 2544

5. sipërfaqja e poc

asgjesimit = 3141

Distanca e Sigurisë

Vatra e Asgjes

PE Piktë furnizimi materij

PUNA Piktë grumbullimi rreth

Rreze

VENDIM
Nr.1472, datë 12.11.2008

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË PËRFUNDIMIT TË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PËR
MINISTRINË E DREJTËSISË DHE INSTITUCIONET, NË VARËSI TË SAJ, SI AUTORITETE
KONTRAKTORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shtyrjen e afatit të përfundimit të procedurave të prokurimit, për vitin 2008, për Ministrinë e Drejtësisë dhe institucionet në varësi të saj, si autoritete kontraktore, nga data 31 tetor më 25 dhjetor 2008, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

**LISTA E OBJEKTEVE DHE AFATET MAKSIMALE PËR SHTYRJEN E AFATIT
TË PROKURIMIT**

Nr.	Objekti	Vlera lekë	Afati për lidhjen e kontratës
1	Blerje karburanti	5 010 100	24.12.2008
2	Sistem kamerizimi, burgjet Korçë dhe Fushë-Krujë	20 000 000	24.12.2008
3	Ushqime koloniale	6 000 000	24.12.2008
4	Pikë lidhje e dytë burgu, Zaharia Krujë	3 350 000	24.12.2008
5	Pus uji burgu Lushnjë	1 800 000	24.12.2008
6	Riparime tualetesh + dyer në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve	700 000	24.12.2008
7	Motogjeneratorë dhe kaldaja për sistemin e burgjeve	7 200 000	24.12.2008
8	Sistem rrufepritës për IEVP Peqin dhe antenën e TV për IEVP Peqin dhe Korçë	5 000 000	24.12.2008
9	Ushqime të freskëta për IEVP Tepelenë	1 452 600	24.12.2008
10	Shtypja e Fletores Zyrtare dhe botime të tjera	18 700 000	24.12.2008

VENDIM
Nr.1473, datë 12.11.2008

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT DHE TË NJOFTIMIT
TË KONTRATËS SË LIDHUR, PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT, TË KRYERA NGA
SHËRBIMI INFORMATIV I SHETIT, SI AUTORITET KONTRAKTOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Shërbimit Informativ të Shtetit t’i përfundojë, deri në datën 20 dhjetor 2008, procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe ndërtime, me fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit të vitit 2008, sipas aneksit nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Brenda këtij afati të përfshihen edhe lidhja e kontratave përkatëse dhe publikimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar në Buletinin e Njoftimeve Publike.

2. Ngarkohen Shërbimi Informativ i Shtetit dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Aneksi nr.1

Nr.	Objekti i prokurimit	Lloji i procedurës
1	Blerje karburanti për (auto, ngrohje dhe ndriçim)	Me negociim me shpallje paraprake të njoftimit të kontratës
2	Blerje pjesë këmbimi për automjete	E hapur
3	Blerje pajisjesh elektroshtëpiake	Kërkesë për propozim
4	Blerje pajisjesh hoteli mobilierie	Kërkesë për propozim
5	Blerje materialesh për funksionimin e pajisjeve speciale (blerje bateri për radio dore dhe UPS)	Kërkesë për propozim
6	Rikonstruktion tarrace, zyra dhe kanalizimeve ujërash të bardha.	Kërkesë për propozim

VENDIM

Nr.1474, datë 12.11.2008

**PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANZIT TË DY AUTOMJETEVE DHE TË DISA TRUPAVE
USHTARAKE ITALIANE, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19, të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë - Porti i Durrësit, në datën 15 nëntor 2008, të 1 (një) automjeti dhe 3 (tri) trupave ushtarake italiane.

2. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Porti i Durrësit - Qafë-Thanë, në datën 25 nëntor 2008, të 1 (një) automjeti dhe 2 (dy) trupave ushtarake italiane.

3. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të automjetit dhe të trupave, që do të kalojnë në datën 15 nëntor 2008, është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit Porti i Durrësit.

4. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të automjetit dhe të trupave, që do të kalojnë në datën 25 nëntor 2008, është pika e kalimit të kufirit Porti i Durrësit dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë.

5. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në Republikën e Shqipërisë janë parashikuar në marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, të marrëveshjes, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe të protokollit shtesë, për marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, ratifikuar me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

6. Automjetet dhe trupat ushtarake italiane, gjatë hyrjes, lëvizjes dhe daljes në/nga territori i Republikës së Shqipërisë, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

7. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.1476, datë 12.11.2008

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.781, DATË 14.11.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KARAKTERISTIKAT TEKNIKE E FUNKSIONALE TË PAJISJEVE FISKALE, SISTEMIT TË INTEGRUAR TË KOMPJUTERIZUAR PËR TRANSFERIMET PERIODIKE, AUTOMATIKE, TË DEKLARIMEVE FINANCIARE, SISTEMIT TË KOMUNIKIMIT, PËR PROCEDURËN E DOKUMENTACIONIT PËR MIRATIMIN E TYRE, DHE PËR KRITERET PËR PAJISJEN, ME AUTORIZIM, TË SHOQËRIVE, TË AUTORIZUARA PËR OFRIMIN E PAJISJEVE FISKALE”

Në mbështetje të pikës 3 të nenit 102 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.781, datë 14.11.2007 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Nën-pika 2.3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2.3 Sistemi i komunikimit, ndërmjet tatimpaguesit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, nëpërmjet një rrjeti të sigurt transmetimi të dhënash të enkriptuara.

Sistemi i komunikimit, ndërmjet shoqërive të regjistruara në degën e tatimpaguesve të mëdhenj dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, duhet të realizohet nëpërmjet një rrjeti të sigurt transmetimi të dhënash të enkriptuara. Shoqëritë e regjistruara në degën e tatimpaguesve të mëdhenj, të cilat përdorin pajisje, sipas kërkesave të këtij vendimi, duhet të sigurojnë transmetimin e të dhënave të xhiros së pajisjes fiskale në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në formë elektronike, në mënyrë të detyrueshme, nëpërmjet sistemit GPRS ose me ndonjë formë tjetër transmetimi, duke e marrë këtë shërbim nga shoqëritë në treg, që ofrojnë një shërbim të tillë, brenda datës 30 prill 2009. Transmetimi i të dhënave mujore të xhiros në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve bëhet brenda datës 10 të muajit pasardhës. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve hyn në marrëveshje kontraktuale bashkëpunimi me operatorët e telefonisë celulare, për sigurimin e shërbimit sipas kësaj skeme.”.

2. Pika 38 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“38. Personat, juridikë dhe fizikë, që do të mbajnë të dhënat e xhiros, nëpërmjet regjistruesit elektronik, janë të detyruar të mbajnë regjistrimet, në përputhje me kërkesat e këtij vendimi, sipas kalendarit të mëposhtëm:

a) Brenda periudhës nëntor 2008 - maj 2009, personat e regjistruar për TVSH-në dhe tatimin mbi fitimin, të cilët administrohen nga drejtoria rajonale tatimore e tatimpaguesve të mëdhenj dhe drejtoria

rajonale e Tiranës.

b) Brenda periudhës janar-dhjetor 2009, personat e regjistruar për TVSH-në dhe tatimpagues të tatimit mbi fitimin, të cilët administrohen nga drejtoritë e tjera rajonale tatimore.

c) Brenda periudhës qershor 2010, personat e regjistruar në biznesin e vogël, të cilët ushtrojnë veprimtari në bashkitë e Tiranës, Durrësit, Vlorës, Gjirokastrës, Fierit, Lushnjës, Beratit, Sarandës, Korçës, Pogradecit, Elbasanit, Shkodrës e Lezhës. Po brenda këtij afati janë të detyruar të mbajnë regjistrime, nëpërmjet regjistruesve elektronikë fiskalë, edhe tatimpaguesit e biznesit të vogël në komunat Shëngjin, Golem, Rashbull, Orikum, Himarë dhe Ksamil.

ç) Brenda periudhës dhjetor 2010, të gjithë tatimpaguesit e tjerë, të biznesit të vogël.

Nuk janë të detyruar të përdorin regjistruesin elektronik fiskal, sipas kërkesave të këtij vendimi, profesionet e lira, ambulantët dhe shërbimi i transportit, të përcaktuara në aneksin nr.5 të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”.

Rregullat dhe procedurat e instalimit dhe të përdorimit të pajisjeve fiskale janë njëlloj të zbatueshme si për tatimpaguesit e regjistruar për TVSH-në dhe tatimin mbi fitimin, ashtu edhe për tatimpaguesit e biznesit të vogël.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1477, datë 12.11.2008

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR.1114, DATË 30.7.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR DISA ÇËSHTJE NË ZBATIM TË LIGJEVE NR.7703, DATË 11.5.1993 “PËR
SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”, NR.9136,
DATË 11.9.2003 “PËR MBLEDHJEN E KONTRIBUTEVE TË DETYRUESHME TË
SIGURIMEVE, SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE, NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË
NDRYSHUAR, DHE NR.7870, DATË 13.10.1994 “PËR SIGURIMET SHËNDETËSORE NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.1114, datë 30.7.2008 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa:

1. Në kreun I “Mbrojtja dhe siguri i detyrueshëm”, të bëhen shtesat e mëposhtme:

a) Pas shkronjës “f” të pikës 1, shtohet shkronja “g”, me këtë përmbajtje:

“g) Të punësuarit, që punojnë me kohë të plotë apo të pjesshme pune, si punëtorë shtëpie, në familjet e të tjerëve, sigurohen në mënyrë të detyrueshme vetëm për degën e pensioneve. Punëtorë shtëpie janë personat, që punësohen nga kryefamiljari, në punë të tilla, si kujdestar për fëmijët, kuzhinier, pastrues, rojë-administrator shtëpie, asistent për të moshuarit etj., apo dhe në shërbime të ndryshme, të kësaj natyre.”.

b) Pas paragrafit të parë të pikës 3, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Punëtorët e punësuar për herë të parë në një profesion të caktuar, në subjekte, që punojnë me material porositësi (fason), për kohën e programuar të formimit profesional, për të kryer punë të kualifikuara, në rastet kur punëdhënësi nuk përfiton financime nga zyra përkatëse e punësimit, sipas përcaktimeve të vendimit nr.47, datë 16.1.2008 të Këshillit të Ministrave “Për programin e nxitjes së punësimit, nëpërmjet formimit profesional”, sigurohen vetëm për aksidente dhe sëmundje profesionale.”.

2. Pas pikës 12 të kreut III “Llojet, shuma dhe shpërndarja e kontributeve”, shtohen pikat 13 e 14, me këtë përmbajtje:

“13. Kontributi i detyrueshëm për sigurimet shoqërore, për personat, që punojnë si punëtorë shtëpie, sipas përcaktimit në shkronjën “g” të pikës 1 të këtij vendimi, të jetë 1 000 (një mijë) lekë/muaj.

14. Kontributi i detyrueshëm për aksidente dhe sëmundje profesionale, për kohën e formimit

profesional të personave të punësuar në subjekte, që punojnë me material të porositësit, të jetë 0.5 për qind e pagës bruto minimale, dhe paguhet totalisht nga punëdhënësi.”.

3. Pas pikës 7 të kreut IV “Procedurat për regjistrim”, shtohen pikat 8 e 9, me këtë përmbajtje:

“8. Kryefamiljarët, që punësojnë persona si punëtorë shtëpie, i lidhin marrëveshjet e punës përmes një marrëveshjeje, me shkrim, ndërmjet palëve, ku, përveç të tjerave, shënohen, detyrimisht, numri i sigurimit shoqëror i personit të punësuar, koha e fillimit të punës dhe zgjatja e saj, “me ose pa afat”, si dhe paga mujore bruto. Në këtë rast, kryefamiljari përcaktohet në rolin e punëdhënësit dhe, si i tillë, ka detyrimin për regjistrim në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Regjistrimi dhe procedurat e pajisjes me numër sigurimi, si për rastin kur i punësuari shërben në një familje apo në më shumë se një familje, bëhet sipas një procedure të thjeshtuar, që përcaktohet nga Ministri i Financave.

9. Formimi profesional nëpërmjet punës, për kualifikimin e punëmarrësit në një profesion të caktuar, të domosdoshëm për veprimtarinë ekonomike, realizohet nga punëdhënësi. Pjesëmarrja në trajnim, në rastet kur është parashikuar vetëm sigurimi për degën e aksidentit në punë, lejohet vetëm një herë dhe jo më shumë se një muaj, për një person. Koha e programuar e formimit profesional nëpërmjet punës, lloji i kualifikimit dhe lista e personave pjesëmarrës deklarohen zyrtarisht në zyrën përkatëse të punësimit, përpara fillimit të trajnimit.”.

4. Pas pikës 9 të kreut V “Pagesa e kontributeve” shtohet pika 10, me këtë përmbajtje:

“10. Kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas këtij vendimi, për personat e punësuar si punëtorë shtëpie, paguhen nga kryefamiljari, i përcaktuar si punëdhënësi, në llogaritë bankare, të përcaktuara sipas procedurave, të vendosura për këtë qëllim. Pagesa e kontributeve bëhet çdo tre muaj, sipas rregullave për pagesat e kontributeve nga personat e vetëpunësuar në biznesin e vogël. Këta persona, sikurse dhe personat e vetëpunësuar në veprimtari tregtare apo shërbim, ambulante, pajisen me librezën e kontributit, nga strukturat e sigurimeve shoqërore, të cilat janë të detyruara ta plotësojnë në vijimësi, në bazë të kontributeve të paguara, dhe vlerësohen të siguruar, për efekt mbrojtjeje nga sigurimet shoqërore, nëse i kanë paguar kontributet e tremujorit pararendës. Në këtë rast në librezë shënohet “Të siguruar vetëm për pension”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1478, datë 12.11.2008

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.1, DATË 10.1.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR PROKURIMIN PUBLIK”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në fund të shkronjës “ç”, “Botimi i njoftimit të fituesit dhe njoftimi i kontratës së lidhur”, të pikës 3 të kreut I “Organizimi i prokurimit publik”, në tekstin e rregullave të prokurimit publik, i cili i bashkëlidhet vendimit nr.1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Nga ky afat bëjnë përjashtim të gjitha procedurat e prokurimit, që zhvillohen nga organet e qeverisjes vendore me fondet e grantit konkurrues për rrugët rurale.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1479, datë 12.11.2008

**PËR SHTYRJEN E AFATIT TË KRYERJES SË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PËR
DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË TATIMEVE, SI AUTORITET KONTRAKTOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të përfundojë, brenda datës 29 dhjetor 2008, procedurat e prokurimit, për mallra e shërbime, me fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit të vitit 2008, sipas aneksit nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Brenda këtij afati përfshihet edhe lidhja e kontratave përkatëse.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ANEKSI 1

Procedurat që zhvillohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve janë këto:

1. Tenderi me objekt: “Mirëmbajtja e sistemeve informatike të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Qendrës Kombëtare të Regjistrimit”, me fond 75 708 000 (shtatëdhjetë e pesë milionë e shtatëqind e tetë mijë) lekë pa TVSH, është zhvilluar në datën 1.10.2008 dhe në datën 28.10.2008 është shpallur njoftim fituesi.

2. Tenderi me objekt: “Blerje *software* për rritjen e sigurisë së të dhënave të SIT dhe automatizimin e shkëmbimit të të dhënave”, i ndarë në lote, me fond 21.666.667 lekë pa TVSH.

Loti i parë: Sistemi i sigurisë së bazës së të dhënave (auditimi) - me fond 16.666.667 lekë pa TVSH;

Loti i dytë: Sistemi i automatizimit të shkëmbimit të të dhënave (Blerje *software* dhe implementim analiza e riskut), me fond 5.000.000 lekë pa TVSH.

Kjo procedurë është zhvilluar në datën 15.10.2008 dhe njoftim fituesi është shpallur në datën 29.10.2008.

3. Tenderi me objekt: “Blerja e sistemit informatik për menaxhimin e sistemit të pajisjeve fiskale në Republikën e Shqipërisë”, me fond limit 16.666 lekë pa TVSH, i pazhvilluar, bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.781, datë 14.11.2007 “Për karakteristikat teknike dhe funksionale të pajisjeve fiskale, sistemit të integruar të kompjuterizuar për transferimet periodike, automatike të deklarimeve financiare, sistemit të komunikimit, për procedurën dhe dokumentacionin për miratimin e tyre dhe për kriteret për pajisjen me autorizim të shoqërive të autorizuara për ofrimin e pajisjeve fiskale”, si dhe kontratën e shkruar nga Ministria e Financave dhe shoqëritë e autorizuara, neni 3 pika II germa “d”.

4. Tenderi me objekt: “Blerje karburanti”, me fond limit: 21.498.493 lekë pa TVSH, i zhvilluar në datën 3.9.2008, shpallur njoftim fituesi më 29.9.2008 ka ngelur pa shpallur njoftimi i kontratës së nënshkruar.

5. Tenderi me objekt: “Blerje orendi dhe pajisje zyre”, me fond limit 16.166.667 lekë pa TVSH, që është zhvilluar në datën 5.11.2008.

6. Tenderi me objekt: “Ruajtje objektsh”, për qarqet:

- Tiranë, me fond 2 069 928 lekë;

- Sarandë, me fond 804 972 lekë;

- Kukës, me fond 1 034 964 lekë, është zhvilluar në datën 8.10.2008 dhe është shpallur njoftim fituesi në datën 24.10.2008;

- Elbasan, me fond 1 494 948 lekë;

- Lezhë, me fond 1 034 964 lekë, pa zhvilluar për dy qarqet pasi është anuluar.

Fondi limit në total i tenderit me objekt: “Ruajtje objektsh” është: 6 439 776 lekë pa TVSH.

7. Tenderi me objekt: “Riparim automjete”, me fond limit 3 501 000 lekë pa TVSH është

zhvilluar në datën 24.9.2008 dhe është shpallur fituesi në datën 23.10.2008.

VENDIM
Nr.1480, datë 12.11.2008

**PËR MIRATIMIN E SHITESËS NR.2 TË KONTRATËS SË MIRATUAR ME VENDIMIN NR.665,
DATË 18.12.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E
PROJEKTKONTRATËS, NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
“LOCKHEED MARTIN GLOBAL, INC”, PËR MODERNIZIMIN E SHËRBIMIT TË TRAFIKUT
AJROR SHQIPTAR”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.7877, datë 30.11.1994 “Për aviacionin civil shqiptar”, dhe të neneve 128 dhe 151 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e shtesës nr.2 të kontratës, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit (Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil) dhe “Lockheed Martin Global, Inc.”, për modernizimin e shërbimit të trafikut ajror shqiptar, të miratuar me vendimin nr.665, datë 18.12.2002 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e projektkontratës, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe “Lockheed Martin Global, Inc.”, për modernizimin e shërbimit të trafikut ajror shqiptar”, të ndryshuar, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Fondet për financimin e shtesës së kontratës të përballohen nga burimet e përcaktuara në marrëveshjen e kredisë, të nënshkruar ndërmjet Agjencisë Nacionale të Trafikut Ajror (ANTA) sh.a. BNP Paribas dhe Export-Import Bank e SHBA-së, më 29.6.2005, si dhe nga të ardhurat vjetore të ANTA sh.a.

3. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil dhe Agjencia Nacionale e Trafikut Ajror për ndjekjen e zbatimit në këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Hyrje:

Paragrafi i parë lexon si më poshtë:

Kjo Marrëveshje, e bërë më 30 dhjetor 2002 dhe e amenduar me 15 gusht 2008, që këtu e më poshtë e quajtur “Kontrata”, lidhet nga/dhe midis Drejtorisë së Përgjithshme të Aviacionit Civil të Qeverisë së Shqipërisë, me zyra kryesore në rrugën “Muhamet Gjollësja” (pranë Parkut të Delegacioneve), Tiranë, Shqipëri, që këtu e më poshtë i quajtur “Blerësi” dhe Lockheed Martin Global Inc, një kompani e varur nga Lockheed Martin Corporation, me zyra kryesore në: 9211 Corporate Boulevard, Rockville në Shtetin e Maryland SHBA, me zyra në Shqipëri, të lokalizuara në Zayed Business Center, 8th floor, rruga “Sulejman Delvina”, Tiranë, Shqipëri, regjistruar si person juridik me anë të vendimit nr.29264, datë 11.3.2003 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, që këtu e më poshtë i quajtur “Shitësi”. Blerësi dhe Shitësi gjithashtu mund të quhen në njëjës “Pala” ose në shumës “Palët”.

Paragrafi katër

Ndryshon si më poshtë:

Data e plotësimit të programit ndryshohet në 2012.

Në fjalinë e dytë, dy ndryshohet në tre.

Paragrafi pesë — faza 1

Lexon si më poshtë:

Të ndihmojë Republikën e Shqipërisë për të siguruar financimin komercial. Të sigurojë produktet dhe shërbimet kryesore afatgjata të nevojshme për të kryer instalimin e një sistemi fillestar automatizimi për të arritur një mjedis të kontrolluar me radar në fazën 2. Të modifikojë dhe rinovojë ndërtesën ACC/APP

ekzistuese për të ndihmuar në instalimin e sistemit fillestar të automatizimit. Të përgatisë ekspozenë për ndërtesën për një ndërtesë të re për kullën/ACC/APP. Të kryejë detyra të ndryshme për operacionet e trafikut ajror. Kjo punë u financua drejtpërdrejt nga të ardhurat e NATA-s. Kjo punë është pjesë përbërëse e kontratës dhe e programit dhe do të konsiderohet pjesë e kontratës dhe e programit për të ndihmuar në llogaritjen e vlerës së programit dhe përmbajtjes për SHBA për qëllimet e marrëveshjes së kreditimit të garantuar nga US ExIm Bank.

Paragrafi 6 - faza 2

Lexon si vijon:

Të sigurojë një sistem fillestar automatizimi për të arritur një kapacitet të kontrollit me radar për trafikun e Lojërave Olimpikë të 2004, duke përfshirë hapjen e një sektori të ri në këtë vend. Të projektojë një ndërtesë të re për kullën/ACC/APP. Të modernizojë komunikimin, navigimin, survejimin dhe nënsistemet e automatizimit të menaxhimit të trafikut ajror proporcionalisht me fondet e siguruar. Të kryejë detyra të ndryshme për operacionet e trafikut ajror. Të krijojë një zyrë për menaxhimin e projektit të kompletuar me staf shqiptar për të pranuar transferimin e teknologjisë dhe aftësive. Kjo punë u financua drejtpërdrejt nga të ardhurat e NATA-s.

Paragrafi shtatë — faza 3

ndryshon si më poshtë:

Faza 3 amendamenti 1 dhe amendamentet e rishikuara

Në përpjesëtim të drejtë me fondet e siguruar. Të sigurojë produkte dhe shërbime siç është përcaktuar në përshkrimin e punës. Të sigurojë përmirësime të sistemit të automatizimit. Të modernizojë komunikimin, navigimin, survejimin dhe nënsistemet e automatizimit të menaxhimit të trafikut ajror. Të kryejë detyra të ndryshme për operacionet e trafikut ajror. Të sigurojë këshilla menaxhimi dhe financiare. Të mbajë një zyrë për menaxhimin e projektit të kompletuar me staf shqiptar për të pranuar transferimin e teknologjisë dhe aftësive. Kjo punë do të financohet nga të ardhurat e NATA-s dhe një hua tregtare.

Neni 1

Data e hyrjes në fuqi

Ndryshon si vijon:

Kjo kontratë e konsoliduar përfshin dispozitat që ndodhen në amendamentin e rishikuar 2 të kontratës dhe do të hyjë në fuqi kur kjo kontratë e konsoliduar, datë 15 gusht 2008, të jetë firmosur nga të dyja palët, Blerësi dhe Shitësi, dhe t'u jetë dorëzuar të dyja palëve.

Neni 2

Sfera e kontratës

Nuk ka ndryshime.

Neni 3

Përkufizime

Paragrafi 3: Blerësi, pronat, personeli dhe mbështetja që sigurohet:

Është shtuar “Ndërtesat” pas “Avion”

Paragrafi 5: Kërkesë për ndryshim:

Është shtuar “ose Shitësi” pas “Blerësi”

Paragrafi 24: Plani i punimeve të programit

Zëvendësuar “4” me “3”

Pas paragrafit 29 “trajnimi teknik” është shtuar paragrafi i mëposhtëm:

Palët e paautorizuara: Neni referencë 21, paragrafi 6. Palët e autorizuar për të ndryshuar, modifikuar, riparuar, ndërlidhur apo instaluar artikuj janë ato të punësuar nga DGCA, NATA ose Lockheed Martin, të cilët kanë kryer kurset përkatëse të trajnimit dhe kanë dokumentacion me shkrim nga punëdhënësi i tyre, ku identifikohen artikujt me të cilët ata janë të autorizuar të punojnë. Puna e autorizuar duhet të dokumentohet në fletëregjistrimin e operacioneve dhe mirëmbajtjes. Palët që nuk plotësojnë përcaktimin e mësipërm për palë të autorizuar janë palë të paautorizuara.

Neni 4

Rendi i përparësisë

Lexon si vijon:

Rendi i përparësisë

Në rast të ndonjë mospërputhjeje apo dykuptimësie midis dokumenteve që formojnë pjesët përbërëse të kësaj kontrate, ajo mospërputhje apo dykuptimësi do të zgjidhet duke përdorur rendin e mëposhtëm të përparësisë së dokumenteve:

1. Afatet dhe kushtet e kontratës, përfshi amendimet e kontratës;
2. Shtojcat numër 1, 2, 3 dhe 4 të afateve dhe kushteve të kontratës, në sekuenca numerike;
3. Çdo dokumentacion tjetër që lidhet në mënyrë kontraktuale;
4. Marrëveshja financiare për fazën 2;
5. Dokumenti i vendimit të Këshillit të Ministrave për studimin e fisibilitetit.

Neni 5

Vendi i kryerjes së punimeve

Asnjë ndryshim.

Neni 6

Plani i kryerjes së punimeve dhe afati i kontratës

Lexon si vijon:

Periodha e kryerjes së punimeve për këtë kontratë (gjithashtu “Afati i kontratës”) është nga fillimisht data e hyrjes në fuqi 30 dhjetor 2002 në 31 dhjetor 2012, datë e cila mund të shtyhet me marrëveshje të përbashkët. Një plan i detajuar i kryerjes së punimeve, duke përfshirë objektivat e ndërmjetme për kryerjen e punimeve, objektivat për dorëzimin, objektivat për pranimin, dhe objektivat për garancinë, është përfshirë në planin e punimeve të programit në shtojcën 3 bashkëngjitur këtij dokumenti.

Neni 7

Artikujt që mund të shiten dhe çmimi

Lexon si vijon:

Artikujt që mund të shiten do të jenë siç specifikohen në përshkrimin e punës midis blerësit dhe shitësit. Vlera fillestare e kësaj kontrate është \$32,977,807 dollarë amerikanë (USD), që përbëhet nga \$3,295,000 USD për fazën 1 dhe \$29,682,807 USD për fazën 2, vlerë së cilës i është shtuar shuma prej \$17,451,831 USD për fazën 3, duke rezultuar në një shumë totale prej \$50,429,638 USD. Amendamenti 2 e rrit shumën totale me \$ 28,351,505 USD për fazën 3, duke rezultuar në një shumë totale prej \$78,781,142 USD. Amendamenti 2 i rishikuar e modifikon amendamentin 2 të firmosur më 30 qershor 2008 dhe e zvogëlon shumën totale me \$ 21,981,142 USD në një shumë totale prej \$ 56,800,000 USD.

Të gjitha çmimet nuk përfshijnë TVSH-në, si dhe taksa, detyrime doganore apo tatime të tjera, të cilat do të zbatohen ndaj faturës në atë masë siç ekzistojnë deri në datën e faturës.

Banka e Shteteve të Bashkuara Export Import Bank siguron sigurimin e riskut për të garantuar financimin e BNP Paribas. Nga ana e saj, Banka e Shteteve të Bashkuara Export Import Bank kërkon që shumica e produkteve dhe shërbimeve të jenë me origjinë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Për shkak se produktet dhe shërbimet e dhëna nga CNS/ATM duhet të plotësojnë standardet europiane dhe duhet të jenë të ndërveprueshme me ndërfaqe europiane, disa kapacitete të kërkuara nuk disponohen në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Për këtë arsye Blerësi dhe Shitësi bien dakord që Shitësi mund të shesë produkte dhe shërbime, dhe Blerësi mund të paguajë për produkte dhe shërbime me fonde që nuk lidhen me Bankën e Shteteve të Bashkuara Export-Import Bank, brenda fondeve të kufizuara nga çmimi i përgjithshëm i kontratës.

Në çdo moment, para kohës së dërgimit të artikujve që mund të shiten, Shitësi rezervon të drejtën të bëjë korrigjimet e nevojshme apo ndryshimet e nevojshme në numrin, komponentët apo faturën e materialeve të pjesës, me kusht që forma, montimi apo funksionimi i pjesës si e tërë apo i komponentëve të saj të mos ndikohet. Të gjithë artikujt jepen me CIF në objektet e Blerësit.

Neni 8

Plani për pagesat

Fshi nenin ekzistues.

Vendos nenin e ri si vijon:

Për pagesën e firmosjes së kontratës, Blerësi duhet ta dërgojë pagesën në bankën e Shitësit brenda

30 (tridhjetë) ditëve pas firmosjes së kontratës me marrjen e 1 (një) kopjeje të kontratës së firmosur dhe 3 (tri) kopje të faturës tregtare të Shitësit në formë origjinale.

Pagesat në vijim duhet t'i paguhen Shitësit sipas objektivave apo datave të treguara në planin e pagesave me faza në shtojcën 4.

Blerësi nuk do të bëjë pagesë për punë që nuk plotëson kriteret e pranimit të kësaj kontrate.

Për planin e pagesës së fazës 2 do të bihet dakord gjatë fazës I, në përputhje me marrëveshjen për financimin.

Faturat për pagesat do të lëshohen nga Shitësi 30 (tridhjetë) ditë kalendarike përpara datës që duhet të bëhet pagesa.

Neni 9

Mënyra/monedha e pagesës

Ndryshon si vijon:

Pagesat do të bëhen me anë të transferimit elektronik të fondeve në llogarinë e Shitësit në:

Citibank NA

111 Wall Street

New York, NY 10043

Account# 30627381

ABA or Routing Number: 021000089

Të gjitha pagesat e treguara janë në dollarë amerikanë dhe duhet të paguhen neto pavarësisht nga pagesat për procedimet e bankave apo konvertimet e monedhave.

Neni 10

Letërkredia dokumentare

Fjalja e shtuar në fund të paragrafit të parë si vijon:

Nuk kishte Letërkredi për fazën 1. Blerësi i pagoi të gjitha faturat nga fondet e Blerësit.

Paragrafët tre dhe katër lexojnë si vijon:

Letërkredia për fazën 3 amendamenti 1 u lëshua më 19 shtator 2007.

Letërkredia për fazën 3, amendamenti 2 i rishikuar do të përcaktohet si pjesë e marrëveshjes së financimit.

Neni 11

Kufizimi i fondeve

Janë bërë ndryshimet e mëposhtme:

Pas paragrafit të parë janë shtuar dy paragrafë të rinj si vijon:

Palët pranojnë faktin se fonde shtesë do të sigurohen nëpërmjet financimit tregtar apo burimeve të tjera për të financuar fazën 3 të kontratës dhe lejuar autorizimin e financimit deri në shumën totale të çmimit të kontratës.

Palët pranojnë faktin se fonde shtesë do të sigurohen nëpërmjet financimit tregtar dhe burimeve të tjera për të financuar amendamentin 2 të rishikuar të kontratës dhe lejuar autorizimin e financimit deri në shumën totale të çmimit të kontratës.

Në paragrafin që fillon “Shitësi bie dakord të kryejë” është shtuar “ky amendament 2 i rishikuar i” pas fjalës “pune për”.

Neni 12

Taksat dhe detyrimet doganore

Paragrafi katër lexon si vijon:

Taksat, detyrimet doganore dhe tatime të tjera në përputhje me amendimin për fazën 3 do të jenë të njëjtat me ato të përcaktuara në nenin 12 të kontratës për fazën 1.

Është shtuar paragrafi i pestë si vijon:

Taksat, detyrimet doganore dhe tatime të tjera në amendamentin 2 të rishikuar për produktet dhe shërbimet e siguruar nga Shitësi dhe furnitorët e Shitësit në çdo nivel do të jenë të njëjtat, me ato të përcaktuara në nenin 12 të kontratës për fazën 1 dhe amendamentin 1 faza 3.

Neni 13
Inspektimi dhe pranimi

Nuk ka ndryshim.

Neni 14
Përdorimi i objekteve

Lexon si vijon:

Blerësi do të sigurojë që Shitësi të marrë të gjitha autorizimet dhe lejet e nevojshme, të cilat e bëjnë atë në gjendje të hyjë në vendet e punimeve dhe të përdorë pronat e siguruar nga Blerësi me qëllim që të kryejë plotësisht detyrimet e tij sipas kontratës.

Neni 15
Aprovimet e dokumenteve

Nuk ka ndryshime.

Neni 16
Paketimi dhe transportimi

Nuk ka ndryshime.

Neni 17
Ndryshon

Lexon si vijon:

Blerësi ose Shitësi mund të kërkojnë ndryshime në sferën e punimeve dhe, nëse pranohet nga pala tjetër, plani për çmimin dhe dispozitat e tjera të kontratës që lidhen me të do të rregullohen me anë të marrëveshjes me shkrim të palëve përpara zbatimit të ndryshimit.

Shpenzimet e Shitësit për shkak të: a) vonesave të shkaktuara nga Blerësi dhe vonesave (që nuk janë vonesa të cilat janë brenda kontrollit të arsyeshëm të Shitësit); b) ndryshimeve në ligjet e zbatueshme dhe kërkesave pas datës së kuotimit të shitësit; dhe c) inspektimeve apo testeve shtesë të kërkuara nga Blerësi përveç atyre të kërkuara në pajtim me programin e Shitësit për sigurimin e cilësisë, do të trajtohen si ndryshime në sferën e punimeve dhe kontrata do të rregullohet.

Neni 18
Gjuha

Nuk ka ndryshime.

Neni 19
Njoftimet

Lexon si vijon:

Çdo njoftim i kërkuar apo i lejuar për t'u siguruar sipas kushteve e afateve të kësaj kontrate do të jetë me shkrim dhe do të jepet duke e dorëzuar atë njoftim dorazi, me faksimile ose me postë rekomande (me postë të regjistruar),

Në rastin e Blerësit, për:

Ervin Mazniku

Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil të Shqipërisë

Po Box 205

Rruga: "Muhamet Gjollesha" (pranë Parkut të Delegacioneve)

Tirana, Albania

Tel: +355 4 25 1220; e-mail - emazniku@dgca.gov.al

Kopje për:
Agjencinë Kombëtare të Trafikut Ajror
Aeroporti Ndërkombëtar: "Nënë Tereza"
Rinas, Albania

Dhe në rastin e Shitësit, për:
Nigel Shreeve
Lockheed Martin Transportation and Security Solutions
2nd Floor, Chester House
Farnborough Aerospace Centre
Farnborough, Hampshire
United Kingdom
Email: nigel.shreeve@lmco.com

Ose në atë adresë tjetër që secila Palë, herë pas here, mund të caktojë me shkrim për veten e vet. Palët do ta konsiderojnë çdo njoftim të dhënë, nëse është dërguar, në datën në të cilën njoftimi është dërguar; nëse është dërguar me telex ose faksimile, në datën e transmetimit me njoftim për marrjen e tij. Posta elektronike e-mail është e përshtatshme për komunikimin zyrtar.

Neni 21

Asistenca për garancinë dhe mirëmbajtjen

Paragrafi 6 lexon si vijon:

Shitësi nuk do të jetë asnjëherë përgjegjës për pajisjet dhe programet kompjuterike që janë ndryshuar, modifikuar apo riparuar jo në mënyrën e duhur nga palë të paaautorizuara; për defektet apo mosfunksionimet që rezultojnë nga trajtimi, ruajtja, operimi, mirëmbajtja, ndërlidhja apo instalimi nga palë të paaautorizuara, si dhe nuk do të jetë asnjëherë përgjegjës për defekte që lindin nga konsumimi normal apo përdorimi i tepërt.

Neni 22

Mirëmbajtja e sistemit

Lexon si vijon:

Shitësi bie dakord të vërë në dispozicion të Blerësit shërbime mirëmbajtjeje afatgjata për sistemin duke e modifikuar këtë kontratë ose me anë të një kontrate për mirëmbajtjen më vete e të palidhur me këtë kontratë që do të hyjë në fuqi me përfundimin e garancive për nënsistemin të dhëna me anë të kësaj kontrate. Ajo kontratë mirëmbajtjeje do të jetë subjekt i negociimeve për kushte dhe afate të pranuar në mënyrë reciproke, duke përfshirë çmimet dhe pagesat, dhe do të hyjë në fuqi nëse kontrata firmoset nga të dyja palët. Sfera dhe gjerësia e shërbimeve që do të sigurohen do të jenë, minimalisht, në përgjithësi në përputhje me nivelin e asistencës për garanci të dhënë sipas kësaj kontrate.

Neni 23

Detyrimet

Nuk ka ndryshime.

Neni 24

Heqja dorë nga një e drejtë

Nuk ka ndryshime.

Neni 25

Lejet dhe licencat

Nuk ka ndryshime.

Neni 26
Mbrojtja e të dhënave

Nuk ka ndryshime.

Neni 27
Licencat për programet kompjuterike/të drejtat për pronën intelektuale

Nuk ka ndryshime.

Neni 28
Shkeljet ligjore

Nuk ka ndryshime.

Neni 29
Kufizim i përgjegjësi

Nuk ka ndryshime.

Neni 30
Dëmshpërblimi

Nuk ka ndryshime.

Neni 30 a
Hiqet

Neni 31
Forca madhore

Nuk ka ndryshime.

Neni 32
Regjimi i kontrollit të eksportit

Nuk ka ndryshime.

Neni 33
Pronat e furnizuara nga Blerësi

Ndryshon si vijon:

Titulli: Është ndryshuar “klienti” në “Blerësi”

Në fjalinë e fundit është shtuar “ndërtesat”.

Neni 34
Kushtet e tjera të realizimit

Ndryshon si vijon:

Në fjalinë e fundit është hequr “ekzistuese” dhe është shtuar “dhe ndërtesat”

Neni 35
Dokumentacioni teknik

Nuk ka ndryshime.

Neni 36
Shërbime inxhinierike

Nuk ka ndryshime.

Neni 37
Transferimi i teknologjisë

Lexon si vijon:
Shitësi do të ndërmarrë zbatimin e transferimit të teknologjisë siç është rënë dakord nga palët.

Neni 38
Kalimi i të drejtave

Nuk ka ndryshime.

Neni 39
Përfundimi

Nuk ka ndryshime.

Neni 40
Ligji udhëheqës dhe vendi i zhvillimit të gjyqit

Nuk ka ndryshime.

Neni 41
Arbitrariteti

Nuk ka ndryshime.

Neni 42
Ndryshime të rrethanave

Nuk ka ndryshime.

Neni 43
Zgjidhjet ligjore ekskluzive

Nuk ka ndryshime.

Neni 44
Ndryshimi i kushteve të punës

Nuk ka ndryshime.

Neni 45
E gjithë marrëveshja

Nuk ka ndryshime.

Shtojca 1: Plani i kërkesave dhe çmimi

Fshi: Shtojca ekzistuese 1
Vendos: Shtojca e re 1

Shtojca 2: Përshkrimi i punës

Fshi: Shtojca ekzistuese 2
Vendos: Shtojca e re 2

Shtojca 3: Plani i zbatimit të kryerjes së punimeve

Fshi: Shtojca ekzistuese 3
Vendos: Shtojca e re 3

Shtojca 4: Plani i pagesës me faza

Fshi: Shtojca ekzistuese 4
Vendos: Shtojca e re 4

Për kushte të tjera të papërcaktuara në këtë amendim nr.2 të kontratës, do të zbatohen dispozitat e kontratës kryesore ALBGENO2-0025, datë 30 dhjetor 2003.

VENDIM
Nr.1482, datë 12.11.2008

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT, TË CIKLIT TË DYTË, PRANË
UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS, NË VITIN AKADEMIK 2008-2009**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, 34, 42 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, pranë Universitetit Politeknik të Tiranës, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, të programeve të studimit, të ciklit të dytë, si më poshtë vijon:

a) Në inxhinieri mjedisi, me profile:

- Trajtim uji;
- Energjetikë.

Në përfundim të këtij programi do të lëshohen diplomat e mëposhtme:

- Diplomë e nivelit të dytë, DND, në inxhinieri mjedisi, profili trajtim uji;
- Diplomë e nivelit të dytë, DND, në inxhinieri mjedisi, profili energjetikë.

b) Në “Inxhinieri ndërtimi”, profili gjeoteknik, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të dytë, DND, në inxhinieri ndërtimi, me profil gjeoteknikë.

2. Programet e studimeve të ciklit të dytë realizohen me 120 kredite dhe zgjatja normale e tyre është dy vite.

3. Këto programe studimi të fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2008-2009.

4. Kuota e pranimeve në programet e mësipërme të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në Universitetin Politeknik të Tiranës, për vitin akademik 2008-2009, të jenë, si më poshtë:

- i) Inxhinieri mjedisi 50;
- ii) Inxhinieri ndërtimi, profili gjeoteknikë 25.

5. Universiteti Politeknik i Tiranës shpërndan kuotat e vëna në dispozicion të tij, në masën jo më pak se 30%, për studentët, që kanë përfunduar të paktën ciklin e parë të studimeve në institucionet e tjera të arsimit të lartë, dhe jo më shumë se 70 %, për ata që i kanë përfunduar këto studime pranë tij. Në rastet kur nuk ka kandidatë nga institucionet e tjera të arsimit të lartë, që plotësojnë kriteret, atëherë Universiteti Politeknik i Tiranës ka të drejtë të plotësojë kuotën e vënë në dispozicion me studentët, që janë diplomuar në të.

Kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve, të përcaktuara nga njësitë kryesore të Universitetit Politeknik të Tiranës, bëhen publike.

6. Tarifa vjetore e shkollimit për studentët, që do të regjistrohen, me kohë të plotë, në vitin

akademik 2008-2009, të jetë sipas pikës 6.b.V të vendimit nr.1337, datë 10.10.2008 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë, për programet e studimit të ciklit të dytë dhe master i nivelit të parë, me kohë të plotë, si dhe për tarifat e shkollimit për këto programe, të miratuara për vitin akademik 2008-2009”.

7. Kandidatët, që u përkasin shtresave sociale, si: të verbër, të shurdhër, invalidë paraplegjikë dhe tetraplegjikë, studentë me aftësi të kufizuara, fëmijët romë apo fëmijët e policëve, të rënë ose të plagosur, për shkak të detyrës, të ish-të përndjekurve politikë, që do të fitojnë të drejtën për të ndjekur një program studimi, të ciklit të dytë, në institucionet publike të arsimit të lartë, do të paguajnë 50% të tarifës së shkollimit.

8. Studenti i nënshtrohet vetëm një tarife vjetore shkollimi.

9. Në çdo program studimi, në ciklin e dytë të studimeve, me kohë të plotë, në vitin akademik 2008-2009, studentët e shkëlqyer nga cikli i parë dhe nga cikli i dytë, nuk e paguajnë tarifën e shkollimit, për vitin akademik pasardhës.

10. Kuotat e pranimeve në programet e studimit të ciklit të dytë, sipas pikës 4 të këtij vendimi, që mbeten të përcaktuara, rishpërndahen sipas institucioneve publike të arsimit të lartë dhe programeve të ndryshme të studimit, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

11. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2008, miratuar për Universitetin Politeknik të Tiranës.

12. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti Politeknik i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1483, datë 12.11.2008

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.547, DATË 9.8.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR KRIJIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fund të pikës 3 të vendimit nr.547, datë 9.8.2006 të Këshillit të Ministrave, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Drejton dhe bashkërendon punën me strukturën e specializuar të Kombeve të Bashkuara, Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike (IAEA), si dhe ndërmjet strukturave shtetërore, institucioneve të specializuara, vendase dhe të huaja, universiteteve dhe qendrave kërkimore-shkencore, vendase dhe të huaja, sektorit privat, organizatave jofitimprurëse, grupeve të interesit etj., për të krijuar infrastrukturën kombëtare të nevojshme (përfshirë kuadrin e nevojshëm ligjor dhe rregullator, strukturat e specializuara të domosdoshme etj.), për vënien në jetë dhe në funksion të programit të energjisë bërthamore në Shqipëri.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.1484, datë 12.11.2008

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.23, DATË 9.1.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

“PËR TARIFAT E PËRDORIMIT TË UJIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 57 të ligjit nr.8093, datë 21.3.1996 “Për rezervat ujore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 1 të vendimit nr.23, datë 9.1.2008 të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 1.1, me këtë përmbajtje:

“1.1 Tarifat e përdorimit të ujit, të parashikuara në pikën 4 të tabelës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, janë 0, kur:

i) në kontratën e koncesionit, për hidrocentrale, të lidhur nga autoriteti përkatës kontraktor, është parashikuar pagimi i tarifës së koncesionit nga ana e koncesionarit;

ii) KESH sh.a. do të jetë shoqëri publike.”.

2. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Financave dhe këshillat e baseneve të ujërave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.1485, datë 12.11.2008

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.160, DATË 13.2.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE, PËR VITIN 2008, NË MINISTRITË DHE INSTITUCIONET QENDRORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.160, datë 13.2.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Ministrisë së Drejtësisë, në numrin e përgjithshëm të punonjësve, të miratuar për vitin 2008, në sistemin e burgjeve, t’i shtohen 200 veta.

2. Numri total i punonjësve buxhetorë, për vitin 2008, për periudhën korrik-dhjetor 2008, bëhet 104 531 veta, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

Lidhja nr.1

Gr.	Ministritë/institucionet	Korrik-dhjetor 2008
3	Kryeministria	128
	- Institucione të tjera qeveritare, nga të cilat:	106
	- Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar	33
	- Agjencia e Prokurimit Publik	36
	- Grupi i Mbikëqyrjes	8

	- Komiteti Shtetëror i Minoriteteve	9
	Agjencia Kombëtare Shoqërisë së Informacionit	20
4	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, nga e cila:	508
	- Drejtoria e Standardeve	18
5	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit nga e cila:	2.109
	- Bordet e kullimit	650
6	Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit	1.362
10	Ministria e Financave, nga e cila:	3135
	- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave	1.027
	- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	1.630
	- Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave	22
11	Ministria e Arsimit dhe Shkencës	43.370
	- Universitetet	3.983
	- Parauniversitar	38.496
12	Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	1.099
13	Ministria e Shëndetësisë	15.408
14	Ministria e Drejtësisë, nga e cila:	4794
	- Avokati i Shtetit	40
	- Zyra e Regjistrimit të Pasurive	400
	- Agjencia Kombëtare e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave	150
15	Ministria e Punëve të Jashtme	188
16	Ministria e Brendshme, nga e cila:	13.065
	- Drejtoria e Rezervave të Shtetit	100
17	Ministria e Mbrojtjes	11800
18	Shërbimi Informativ Shtetëror	950
20	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave	155
22	Akademia e Shkencave	45
25	Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta	1.435
26	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave	1.401
31	Agjencia Telegrafike Shqiptare	82
50	Instituti i Statistikës	169
57	Qendra Kombëtare e Kinematografisë	10
59	Instituti i Rehabilitimit të të Përndjekurve Politikë	25
78	Ministria e Integritetit	77
82	Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	6
	Total	101.427
	Totali për institucionet e pavarura	3.104
	Totali i punonjësve buxhetorë	104.531

VENDIM
Nr.1486, datë 12.11.2008

**PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANZIT TË DY AUTOKOLONAVE USHTARAKE ITALIANE,
PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me

propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë - Porti i Durrësit, në datën 12 nëntor 2008, të një autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 3 (tri) automjete dhe 6 (gjashtë) trupa.

2. Lejimin e kalimit tranzit, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Porti i Durrësit - Qafë-Thanë, në datën 13 nëntor 2008, të një autokolone ushtarake italiane, të përbërë nga 13 (trembëdhjetë) automjete dhe 27 (njëzet e shtatë) trupa.

3. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonën, e përmendur në pikën 1 të këtij vendimi, është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit Porti i Durrësit.

4. Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë për autokolonën, që përmendet në pikën 2 të këtij vendimi, është pika e kalimit të kufirit Porti i Durrësit dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë.

5. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në Republikën e Shqipërisë janë parashikuar në marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, të marrëveshjes, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe të protokollit shtesë, për marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre”, ratifikuar me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

6. Autokolonat ushtarake italiane, gjatë hyrjes, lëvizjes dhe daljes në/nga territori i Republikës së Shqipërisë, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

7. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.1518, datë 12.11.2008

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONAREVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I PIKËS SË KALIMIT
KUFITAR QAFË-BOTË/KONISPOL**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i pikës së kalimit kufitar Qafë-Botë/Konispol, sipas listës dhe planrilevimit, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 12 000 (dymbëdhjetë mijë) m², truall, të vlerësuar me çmimin 2 851 lekë/m², për zonën e Konispolit, me vlerë të përgjithshme shpronësimi 34 212 000 (tridhjetë e katër milionë e dyqind e dymbëdhjetë mijë) lekë.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 556 000 (pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 34 212 000 (tridhjetë e katër milionë e dyqind e dymbëdhjetë mijë) lekë, të përballohet nga “Llogaria speciale”, e krijuar si transfertë kapitale, për t’u përdorur për shpronësimet.

6. Shpronësimi të fillojë më 30.11.2008 dhe të përfundojë më 30.12.2008.

7. Afati i punimeve të ndërtimit të fillojë brenda 1 muaji nga data e hyrjes në fuqi e këtij vendimi dhe të përfundojë brenda 12 muajve.

8. Ngarkohen Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe ZRPP-ja për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

Nr.	Emri	Mbiemri	Sipër. m ²	Çmimi mesa. Lekë/m ²	Vlera paraprake lekë
1.	Arben	Dojaka	333	2851	950333
2.	Tritan	Dojaka	333	2851	950333
3.	Pranvera	Fania	333	2851	950333
4.	Mimoza	Berisha	333	2851	950333
5.	Flora	Shehu	333	2851	950333
6.	Suzana	Dojaka	333	2851	950333
7.	Myrvete	Kopliku	1 833	2851	5 226 833
8.	Artan	Shehu	917	2851	2613417
9.	Lulezim	Shehu	917	2851	2613417
10.	Kushtrim	Taka	500	2851	1 425 450
11.	Elvira	Taka	500	2851	1425450
12.	Evis	Taka	417	2851	1187917
13.	Mecovite	Taka	417	2851	1187917
14.	Kahreman	Bejleri	667	2851	1 900 667
15.	Silvana	Rista(Bejleri)	583	2851	1 663 308
16.	Lejla	Shehu(Bejleri)	583	2851	1 663 308
17.	Liljana	Haxhiymeri	333	2851	950333
18.	Firdes	Caushi	333	2851	950 333
19.	Fatmira	Kosta	1 000	2851	2851 000
20.	Linda	Haxhiymeri	333	2851	950333
21.	Merita	Xhaferaj	333	2851	950333
22.	Genci	Gjanci	111	2851	316778
23.	Lizeta	Gjanci	111	2851	316778
24.	Niko	Gjanci	111	2851	316778
Shuma gjithsej			12 000	2851	34 212 000

PLAN RILEVIMI (PRETENDIM PRONESIE)

PERGATITI

TOPOGRAF RUHAN BALANI

NR LICENCE_Nr _TZ 0484 Dt 07/09/2004

DATA E PERGATITJES 08/07/2008

TOPOGRAF
RUHAN BALANI
Nr. Lic: TZ 0484

IDENTIFIKIMI IPASURISE

ZONA KADASTRALE 2217

NR PASURISE FAQE VOL

INDEKSI I HARTES SR-KONI-64/J-34-17-(6-C)

SHKALLA 1:2500


ADRESA E PASURISE RRETHI SARANDE

Q\F KONISPOL RRIL NR

Pig SH K AP

PRONARI

ALUSH TAKA



SIPERFAQE E TOKES 12000.0m2

KORDINATAT

	Y	X
1	427948.78	4391537.82
2	428000.88	4391497.82
3	428014.69	4391432.95
4	428010.75	4391410.97
5	428017.16	4391352.18
6	428007.09	4391347.51
7	427995.30	4391357.28

	Y	X
8	427980.33	4391382.77
9	427926.60	4391422.66
10	427902.41	4391475.93
11	427927.15	4391503.83
12	427939.47	4391537.51

UDHËZIM

Nr.37, datë 20.11.2008

PËR PËRDORIMIN E TË ARDHURAVE NGA PROCESI I LEGALIZIMIT

Në mbështetje të nenit 32 dhe 43 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

1. Të ardhurat e arkëtuara nga ALUIZNI në procesin e legalizimeve do të ndahen dhe përdoren si më poshtë:

a) Të ardhurat e arkëtuara nga transferimi i pronësisë së parcelës ndërtimore, sipas nenit 32 pika “a”, do të ndahen:

- 20% për buxhetin e njësisë së qeverisjes vendore. Këto fonde njësitë e qeverisjes vendore do t'i përdorin këto të ardhura për investime në infrastrukturë e shërbime për zonën/bllokun me ndërtime të legalizuara dhe për sistemimin me banesë të familjeve të pastreha;

- 80% për Buxhetin e Shtetit dhe do të përdoren për fondin e kompensimit financiar, të parashikuar nga ligji nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”.

b) Të ardhurat e arkëtuara sipas pikës 1 të nenit 32, pra ato nga pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë, kalojnë për llogari të njësisë të qeverisjes vendore ku ndodhet objekti pa leje. Këto të ardhura përdoren për zhvillimin e infrastrukturës dhe urbanizimit të territoreve që legalizohen.

c) Të ardhurat e arkëtuara sipas nenit 43, i kalojnë plotësisht njësisë të qeverisjes vendore.

d) Të gjitha të ardhurat e arkëtuara të vëna në dispozicion sipas pikave të mësipërme, njësitë e qeverisjes vendore duhet t'i përdorin vetëm sipas destinacionit të përcaktuar në ligj, por pas vendimit të këshillit përkatës.

2. Zyrat rajonale të ALUIZNI-t duhet të udhëzojnë qytetarët që të ardhurat për procesin e legalizimit, të derdhen në llogarinë e të ardhurave të degës përkatëse të thesarit.

3. Me arkëtimin e të ardhurave, të përcaktuar në nenet 32 dhe 43 të ligjit nr.9482 datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, dega e thesarit të qendrës rajonale dhe zyra rajonale e ALUIZNI-t bëjnë aktrakordin mujor, të cilit i bashkëlidhet lista e njësisë vendore ku ndodhet objekti informal (lista përpilohet në bazë të rakordimit të zyrës rajonale të ALUIZNI-t me njësitë vendore përkatëse).

Zyra rajonale e ALUIZNI-t do ta përcjellë një kopje të konfirmuar zyrtarisht nga dega përkatëse e thesarit të aktrakordimit dhe kërkesën për rritjen e autorizuar të fondeve buxhetore në zyrën qendrore të ALUIZNI-t në Tiranë. Dega e thesarit të qendrës rajonale do të kryejë autorizimin në bazë të kërkesës së rritjes së autorizuar të konfirmuar zyrtarisht nga drejtori i përgjithshëm i Zyrës Qendrore të ALUIZNI-t.

Për fondet që shpenzohen nga njësitë vendore, kërkesa e rritjes së autorizuar të konfirmuar zyrtarisht nga Drejtori i Përgjithshëm i zyrës qendrore të ALUIZNI-t do të dërgohet në degën e thesarit të distriktit ku ndodhen njësitë vendore nga zyra përkatëse rajonale e ALUIZNI-t. Dega e thesarit të distriktit (jo e qendrës rajonale) do t'i akordojë fondet njësisë vendore sipas shumave të autorizuar në kërkesën e rritjes së autorizuar të konfirmuar zyrtarisht nga Drejtori i Përgjithshëm i Zyrës Qendrore të ALUIZNI-t.

4. Për të gjitha derdhjet e arkëtuara deri tani në llogaritë bankare të të ardhurave të degës së thesarit në distrikt (jo në qendrën e rajonit) do të bëhet aktrakordin (bashkëlidhur fotokopje të dokumentit bankar të derdhjes) me përfaqësuesin e zyrës rajonale të ALUIZNI-t. Aktrakordini depozitohet në degën e thesarit të qendrës rajonale. Dega e thesarit e qendrës rajonale operon sipas procedurës së mësipërme.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

UDHËZIM

Nr.39, datë 11.11.2008

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT TË VERIFIKIMIT DHE TË MARRJES NË DORËZIM TË PAJISJEVE TË MOBILIERISË PËR ARSIMIN BAZË DHE TË MESËM, NË INSTITUCIONET E

VARËSISË SË MASH

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr.6942, datë 25.12.1984 “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare” dhe vendimit nr.70, datë 11.3.1985 të Këshillit të Ministrave “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Ngritjen pranë çdo DAR/ZA të komisionit të verifikimit dhe marrjes në dorëzim të pajisjeve të mobilierisë për arsimin bazë dhe të mesëm, mbi bazën e kontratës së lidhur nga MASH me shoqërinë kontraktuese.

2. Përbërja e komisionit për çdo DAR/ZA, të jetë si më poshtë:

- a) Drejtori i DAR/ZA;
- b) Përgjegjësi i sektorit ekonomik të DAR/ZA;
- c) Inxhinieri i DAR/ZA (specialist i fushës);
- d) Drejtori i shkollës;
- e) Magazinieri i institucionit (DAR/ZA).

3. Komisioni i verifikimit dhe i marrjes në dorëzim të pajisjeve të mobilierisë për arsimin bazë dhe të mesëm, i ngritur pranë çdo DAR/ZA zbaton të gjitha procedurat për administrimin, ruajtjen dhe marrjen në dorëzim të pajisjeve të mobilierisë, të përcaktuara në ligjin nr.6942, datë 25.12.1984 “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare” dhe vendimin nr.70, datë 11.3.1985 të Këshillit të Ministrave “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale dhe monetare” të ndryshuar.

4. Akti i verifikimit dhe i marrjes në dorëzim të paraqitet nga çdo DAR/ZA brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e marrjes në dorëzim të mallit, në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, (Drejtorinë e Planifikimit Buxhetor), i shoqëruar me faturat tatimore të furnizuesit dhe fletëhyrjen e institucionit përfitues (e konfirmuar dhe e vulosur nga drejtori i DAR/ZA). Akti i verifikimit dhe i marrjes në dorëzim të shoqërohet me procesverbalet përkatëse, në rast se konstatohen të meta në cilësi dhe sasi të mallit.

5. Drejtoria e Menaxhimit të Përditshëm mbikëqyr procesin e shpërndarjes dhe marrjes në dorëzim të pajisjeve të mobilierisë për arsimin bazë dhe të mesëm.

6. Ngarkohen për ndjekjen dhe zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Planifikimit Buxhetor, Drejtoria e Menaxhimit të Përditshëm, Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme në MASH dhe çdo DAR/ZA.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SHKENCËS

Fatos Beja

VENDIM

Nr.127, datë 14.11.2008

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ENPOWER ALBANIA” SHPK PËR KRYERJEN E AKTIVITETIT TË TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 9 dhe 13, pikat 1, germa “d”, dhe 8, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 10, pikat 1, 6 dhe 7, të “Rregullores për procedurat e

licencimit, modifikimit, transferimit të plotë, të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, dhe nenit 18, pikat 1, germa “a”, dhe 3, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.44, datë 24.7.2007, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 14.11.2008, mbasi shqyrtoi kërkesën për rishqyrtim të aplikimit të paraqitur nga shoqëria “Enpower Albania” sh.p.k., për t’u licencuar në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

dhe konstatoi se:

1. Me vendimin nr.121, datë 9.10.2008, Bordi i Komisionerëve vendosi mosfillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Enpower Albania” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, për shkak të mosparaqitjes së aplikimit në përputhje me dokumentacionin e kërkuar sipas rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë, të pjesshëm dhe rinovimit të licencave.

2. Rregullorja për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë, të pjesshëm dhe rinovimit të licencave në nenin 10 parashikon mundësinë e aplikuesit për të paraqitur një aplikim të ri brenda tre muajve nga marrja e vendimit për mosfillimin e procedurave të licencimit.

3. Aplikimi i ri i shoqërisë “Enpower Albania” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë të pjesshëm dhe rinovimit të licencave si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c” është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “f” dhe “g”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b” dhe “d”) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.10) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordin i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë “Enpower Albania” sh.p.k., për kryerjen e aktivitetit të tregtimit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM

Nr.128, datë 14.11.2008

PËR AUTORIZIMIN E SHOQËRISË “E-VENTO SRL ALBANIA”, PËR NDRYSHIMIN E AKSIONARIT QË KONTROLLON INTERESAT (ZOTËRON PAKETËN KONTROLLUESE)

Në mbështetje të neneve 9 dhe 15 pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikës 12.5 të “Licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, Bordin i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 14.11.2008, mbasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria “E-VENTO s.r.l. Albania” sh.p.k., për marrjen e autorizimit për shtimin e aksionarëve të shoqërisë, dhe relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

dhe konstatoi se:

1. Shoqëria “E-VENTO s.r.l. Albania” sh.p.k. është licencuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.84, datë 17.7.2008.

2. Propozimi për rishpërndarjen dhe shtimin e aksionarëve të “E-VENTO s.r.l. Albania” sh.p.k., shkakton ndryshimin e aksionarit që kontrollon interesat (zotëron paketën kontrolluese).

3. Ndryshimi i aksionarit që kontrollon interesat (zotëron paketën kontrolluese) sipas shoqërisë i shërben shtimit të kapacitetit teknik të kompanisë dhe uljes në mënyrë të ndjeshme të nivelit të kreditimit nga bankat për realizimin e investimit, pasi financimi i projektit do të bëhet me burime të brendshme.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të autorizojë shoqërinë “E-VENTO s.r.l. Albania”, për ndryshimin e aksionarit që kontrollon interesat (zotëron paketën kontrolluese).

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM

Nr.739, datë 7.11.2008

**PËR ZGJERIMIN E ZONËS SË LICENCIMIT TË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT
VENDOR “RADIO LOGOS”**

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë, radio e televizivë”, si dhe frekuencave dhe kanaleve të lira të shpallura në mënyrë publike, në mbështetje të vendimit nr.709, datë 16.7.2008, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të miratojë zgjerimin e zonës së licencimit të subjektit privat fizik z.George Sturm, për radion vendore private “Radio Logos”, sipas licencës nr.067/FML, për rrethet Librazhd dhe Pogradec.

2. Karakteristikat teknike janë pjesë e licencës përkatëse dhe u nënshtrohen të gjitha kushteve të saj.

3. Ngarkohet administrata e KKRT-së për pasqyrimin e ndryshimeve përkatëse në licencën e subjektit.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM

Nr.740, datë 7.11.2008

**PËR ZGJERIMIN E ZONËS SË LICENCIMIT TË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT VENDOR
“TV ORA”**

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë, radio e televizivë”, si dhe frekuencave dhe kanaleve të lira të shpallura në mënyrë publike, në mbështetje të vendimit nr.709, datë 16.7.2008, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të miratojë zgjerimin e zonës së licencimit të subjektit “ORA” sh.p.k., për televizionin vendor privat “TV ORA”, sipas licencës nr.084/TVL, në prefekturën Fier.

2. Karakteristikat teknike janë pjesë e licencës përkatëse dhe u nënshtrohen të gjitha kushteve të saj.
3. Ngarkohet administrata e KKRT-së për pasqyrimin e ndryshimeve përkatëse në licencën e subjektit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
Nr.741, datë 7.11.2008

PËR DHËNIE LICENCE PËR TELEVISIONIN VENDOR PRIVAT “TV D1”
SUBJEKTIT: “TV D1” SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë, radio e televizivë”, si dhe frekuencave dhe kanaleve të lira të shpallura në mënyrë publike, në mbështetje të vendimit nr.709, datë 16.7.2008, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit “TV D1” sh.p.k. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv vendor privat në fushën e transmetimeve tokësore analogjike, me afat deri më 31.12.2012 nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal rrethin e Peshkopisë.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
Nr.742, datë 7.11.2008

PËR DHËNIE LICENCE PËR RADION VENDORE PRIVATE “RADIO CITY”
SUBJEKTIT: “RADIO CITY” SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë, radio e televizivë”, si dhe frekuencave dhe kanaleve të lira të shpallura në mënyrë publike, në mbështetje të vendimit nr.709, datë 16.7.2008, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit “Radio City” sh.p.k. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator radiofonik vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për një periudhë prej 3 (tre) vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal rrethet Tiranë-Durrës.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
Nr.743, datë 7.11.2008

PËR MOSDHËNIE LICENCE PËR RADION PRIVATE VENDORE “RADIO ORA”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë, radio e televizivë”, si dhe frekuencave dhe kanaleve të lira të shpallura në mënyrë publike, në mbështetje të vendimit nr.709, datë 16.7.2008, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të mos licencojë për transmetim radiofonik privat analogjik tokësor subjektin “ORA” sh.p.k., pasi në përfundim të vlerësimit me pikë, ky subjekt u rendit në vend të dytë.
2. Subjekti mund të ankohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
Nr.744, datë 7.11.2008

PËR MOSDHËNIE LICENCE PËR RADION PRIVATE VENDORE “RADIO ALFA KABËLL”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë, radio e televizivë”, si dhe frekuencave dhe kanaleve të lira të shpallura në mënyrë publike, në mbështetje të vendimit nr.709, datë 16.7.2008, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të mos licencojë për transmetim radiofonik privat analogjik tokësor subjektin “ALFA Kabëll” sh.p.k., pasi në dokumentacionin e paraqitur mungonin deklaratat notoriale dhe deklaratat e vërtetësisë së dhënave.
2. Subjekti mund të ankohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
Nr.745, datë 7.11.2008

PËR MOSDHËNIE LICENCE PËR RADION PRIVATE VENDORE “RADIO G-KAM”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë, radio e televizivë”, si dhe frekuencave dhe kanaleve të lira të shpallura në mënyrë publike, në mbështetje të vendimit nr.709, datë 16.7.2008, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të mos licencojë për transmetim radiofonik privat analogjik tokësor subjektin “G-KAM” sh.p.k., pasi në dokumentacionin e paraqitur mungonin ekstrakti i QKR-së, së bashku me statutin dhe aktin e themelimit, si dhe plani i zbatimit të projektit.
2. Subjekti mund të ankohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr.1267, datë 17.7.2008, shpall të vdekur shtetasin Kristaq Zarka, me datë vdekjeje 11.11.1991.

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr.2733, datë 30.10.2008, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetases Enerjeta Nazarko, e datëlindjes 1989, lindur dhe banuese në Ersekë, dhe caktimin e nënës së saj Fatmira Nazarko, për realizimin e të drejtave dhe përmbushjen e detyrimeve.

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, në vendimin nr.1456, datë 27.10.2008, shpall të vdekur shtetasin Nesim Braho, i biri i Etemit dhe Fadiles, i datëlindjes 25.10.1970, me datë vdekjeje 15.3.2001.

KËRKESË

Shtetasja Behije Gjinollari, e bija e Qaniut dhe e Soses, e datëlindjes 1940, lindur në Skrapar dhe banuese në fshatin Portëz, Fier, kërkon shpalljen të zhdukur të bashkëshortit të saj, Gjilard Gjinollari.

KËRKUESJA
Behije Gjinollari

KËRKESË

Shtetasja Antonjeta Elezi, e bija e Markut dhe e Ages, e datëlindjes 1941, lindur dhe banuese në Tiranë, kërkon shpalljen të vdekur të nënës së saj, Age Elezi.

KËRKUESJA
Antonjeta Elezi

KËRKESË

Shtetasja Selime Tabaku, e bija e Aliut, e datëlindjes 1964, banuese në fshatin Velagosht, komuna Perondi, Kuçovë, kërkon shpalljen të zhdukur të bashkëshortit të saj, Sali Tabaku.

KËRKUESJA
Selime Tabaku

KËRKESË

Shtetasja Nafie Matopalaj, e bija e Xhezos, e datëlindjes 1947, lindur në Progonat, Tepelenë, kërkon shpalljen të vdekur të bashkëshortit të saj, Shyqyri Xhevit Matopalaj.

KËRKUESJA
Nafie Matopalaj

KËRKESË

Shtetasja Mynevere Metushi, e bija e Besimit, e datëlindjes 1942, banuese në Kuçovë, kërkon shpalljen të zhdukur të djalit të saj, Klement Metushi.

KËRKUESJA
Mynevere Metushi

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 2.12.2008
Doli nga shtypi më 2.12.2008

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Tiranë, 2008

Çmimi 48 lekë